



## **Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë**

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021

**PËRMBAJTJA**

**FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE

2

PASQYRA E TEPRICAVE/MUNGESAVE

3

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

4

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

5



## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Menaxhmentit të Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë më 31 Dhjetor 2021, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Ligjet aktuale ne fuqi.

#### Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

#### Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjet aktuale në fuqi dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujdijë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

### Përqjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruarat të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Astrit Musa – Auditor Ligjor  
ACA – Audit & Consulting Associates  
Prishtinë, Kosovë  
22 Mars, 2022



**Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë**  
**Pasqyra e Pozitës Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)
<b>ASETET</b>			
<b>Asetet qarkulluese</b>			
Paraja dhe gjendja në banka	3	167,694	164,001
Avanset	4	30,494	27,165
Totali i asetëve qarkulluese		198,188	191,165
<b>TOTALI I ASETËVE</b>		<b>198,188</b>	<b>191,165</b>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>Detyrimet rrjedhëse</b>			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	5	6,451	3,989
Të hyrat e shtyera	6	191,737	187,176
Totali i detyrimeve rrjedhëse		198,188	191,165
<b>Ekuiteti</b>			
Saldoja e bartur		-	-
Net (deficiti)/suficiti i vitit		-	-
Totali i ekuitetit		-	-
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT</b>		<b>198,188</b>	<b>191,165</b>

Pasqyrat financiare janë nënshkruar në 22 Mars 2022 nga:

**Marigona Shabiu**

Drejtoreshë Ekzekutive

**Enis Selimi**

Menaxher financiar dhe administrativ

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 10 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë**  
**Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

	Shënimi	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat	7	420,917	274,482
<b>Totali i të hyrave</b>		<u>420,917</u>	<u>274,482</u>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet e pagave	8	151,260	97,843
Shpenzimet tjera operative	9	269,657	176,638
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<u>420,917</u>	<u>274,482</u>
<b>Pjesa e mbetur</b>		<u>-</u>	<u>-</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 10 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë**  
**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

---

	Teprica/Mungesa e akumuluar
<b>Pasqyra e Tepricave/Mungesave</b>	
<b>Më 1 janar 2020</b>	(96)
Teprica (mungesa) për vitin	96
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<u>-</u>
<b>Më 1 janar 2021</b>	-
Teprica (mungesa) për vitin	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<u>-</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 10 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë**  
**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2021 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2020 (në EUR)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese</b>		
<b>Mbetja gjatë operimit</b>	-	-
Rregulluar për:		
Ndryshimet në avanset për partnerët	(3,330)	(27,165)
Ndryshimet në llogaritë e pagueshme	2,462	(1,486)
Ndryshimet në të hyrat e shtyera	4,561	126,950
Ndryshimet në mbetjet	-	96
<b>Paratë e gjeneruara nga operimet</b>	<u><b>3,693</b></u>	<u><b>98,396</b></u>
<b>Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent</b>	<b>3,693</b>	<b>98,396</b>
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	164,001	65,604
<b>Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor</b>	<u><u><b>167,694</b></u></u>	<u><u><b>164,001</b></u></u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 10 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare



**Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

---

**1. HYRJE**

Organizata u themelua me emrin Nisma Rinore nga 11 themelues në Beograd në 1 nëntor 2003. Nisma Rinore u regjistrua në formën ligjore të një shoqate në Ministrinë Serbe për të Drejtat e Pakicave Njerëzore dhe Etnike më 13 nëntor 2003. Në tetor 2004, OJQ-ja u reregjistrua në Beograd me emrin e ri Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YIHR).

Iniciativa e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut Zyra në Prishtinë është regjistruar si organizatë joqeveritare në Ministrinë e Administratës Publike të Republikës së Kosovës me numrin 5300445-8 të datës 13 nëntor 2004.

Në vitin 2011 është regjistruar si OJQ lokale me emrin juridik Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë dhe i është lëshuar OJQ-ja e re me numër 5113352-8.

**Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

---

**2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL**

**2.1 Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare për Organizatën janë përgatitur në bazë të kontabilitetit të keshit për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

**2.2 Valuta e përdorur**

Valuta funksionale e Organizatës është valuta e Bashkimit Evropian Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

**2.3 Të arkëtueshmet tregtare**

Të arkëtueshmet tregtare fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas mbarten me kosto minus provizionet, nëse ka. Një provizion njihet kur ka dëshmi objektive që Organizata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Shembuj të dëshmimeve objektive mund të jenë vështirësitë e mëdha financiare të klientit, probabiliteti i madh që klienti të falimentojë si dhe vonesat e vazhdueshme në pagesa.

**2.4 Të arkëtueshmet tjera**

Në llogaritë e të arkëtueshmeve tjera përfshihet parapagimet dhe pasuritë e tjera qarkulluese. Parapagimet mbahen me kosto minus provizioni nëse ka. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti.

**2.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë kosideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shume se tre muaj.

**2.6 Të pagueshmet tregtare**

Shumat e pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallërat dhe shërbimet që janë marrë.

**2.7 Tatimet**

Organizata u themelua si një organizatë joqeveritare, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si një OJQ sipas ligjeve në fuqi të Kosovës.

**Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

---

**2.8 Njohja e të hyrave**

Të hyrat nga grantet njihen si të ardhura në periudhën kur paguhen. Në fund të vitit sasia e tepërt e të ardhurave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

**2.9 Shpenzimet**

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit.

**2.10 Përfitimet e të punësuarve**

Organizata, në rrjedhën normale të saj, bën pagesa në buxhetin e shtetit për llogari të puntorëve. Puntorët e Organizatës janë anëtarë të planit shtetëror të pensioneve. Të gjitha kontributet e tilla në skemat e pensioneve të detyrueshme qeveritare shpenzohen kur ato ndodhin. Organizata nuk operon asnjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas daljes në pension dhe, rrjedhimisht, nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pensionet.

Për më tepër, Organizata nuk ka detyrime materiale për të siguruar përfitime të mëtejshme për puntorët paraprak dhe aktual.

**Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

**3. PARAJA DHE EKVIVALENTET E PARASË**

	Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)
Paraja në bankë-ProCredit	167,563	163,881
Paraja në arkë	131	119
<b>Totali i parasë dhe gjendjes në bankë</b>	<b>167,694</b>	<b>164,001</b>

**4. AVANSET TE PARTNERET**

	Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)
Mlada Aktivna	7,695	-
NGO Center for Peace and Tolerance (CPT)	6,138	4,261
NSI	5,738	-
KRCT	5,562	-
NGO Rinia Aktive e Gjakoves	5,039	2,323
Avanset e dhëna tek stafi	208	-
NGO Integra	118	5,945
Parapagimet tek individet	17	-
NGO Reconciliation Empowering Communities	-	4,226
NGO Syri I Vizionit	-	2,770
NGO Ec ma ndryshe	-	2,537
NGO Initiative for Progress	-	2,366
NGO Community Building Mitrovica (CBM)	-	2,757
YIHR Serbia	(20)	(20)
<b>Totali i avanseve</b>	<b>30,494</b>	<b>27,165</b>

**5. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE**

	Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)
Detyrimet e tatimeve dhe pagave	3,573	471
Llogaritë e pagueshme tregtare	2,181	2,940
Detyrimet tjera	697	578
<b>Totali i llogarive të pagueshme tregtare dhe tjera</b>	<b>6,451</b>	<b>3,989</b>

**Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

**6. TË HYRAT E SHTYRA**

	Të hyrat e shtyra 2020 ( në EUR)	Të hyrat e pranuar gjatë 2021 (në EUR)	Shpenzimet e gjatë vitit 2021 (në EUR)	Pjesa e kthyer tek donatorët (në EUR)	Të hyrat e shtyra për vitin vijues ( në EUR)
Ambasada Zvicerane 2021	47,599	34,994	43,981	-	38,611
NED 2021	23,693	39,745	47,512	-	15,926
Erasmus Plus	21,394	8,205	2,472	-	27,127
UNDP Partneriteti zviceran	16,650	1,850	-	-	18,500
INL Improve Access to Justice	15,987	56,709	66,959	-	5,738
USAID - Dialogu për të rinjët kosovarë	15,886	85,576	106,885	-	5,423
UNRESTRICTED FUNDS	9,967	13,657	8,999	-	14,625
INL	9,613	93,285	70,985	-	31,913
UNMIK	9,024	10,753	16,727	1,757.28	1,293
Youth Artivists for Change	6,955	4,119	15	-	11,059
UNDP Fuqizimi i aktiviteteve	3,846	3,078	7,160	-	235
ECMI (Projekti European)	3,315	-	-	3,732.63	418
Shared Narratives YIHR Croatia	1,164	-	-	-	1,164
PYN - USD	1,030	-	-	-	1,030
Kosova 2.0	590	-	-	589.71	-
GIZ	414	14,730	15,144	-	-
NED	48	-	-	-	48
UNIMK 22	-	22,522	5,084	-	17,438
Ministry of Culure	-	10,000	-	-	10,000
Helsinki Committee	-	1,266	247	-	1,020
Australian Embassy	-	2,460	2,460	-	-
SIDA	-	7,875	8,593	-	718
CMB USAID	-	20,732	17,695	-	3,037
<b>Total të hyrat e shtyera</b>	<b>187,176</b>	<b>431,557</b>	<b>420,917</b>	<b>6,080</b>	<b>191,737</b>

**7. TË HYRAT**

	Të hyrat e pranuar gjatë 2021 (në EUR)	Fondet e shfrytëzuara gjatë 2021 (në EUR)	Të hyrat e pranuar gjatë 2020 (në EUR)	Fondet e shfrytëzuara gjatë 2020 (në EUR)
INL	149,994	137,944	137,515	134,657
USAID - Kosovo Youth Dialogue	85,576	106,885	71,949	61,726
NED	39,745	47,512	40,292	27,147
Ambasada Zvicerane	34,994	43,981	49,994	2,395
UNMIK	33,276	21,811	10,788	1,764
CMB USAID	20,732	17,694.97	-	-
GIZ	14,730	15,144	29,000	28,586
UNRESTRICTED FUNDS	13,657	8,999	11,619	8,159
Ministry of Culure	10,000	-	-	-
Erasmus Plus	8,205	2,472	15,831	1,679
SIDA	7,875	8,592.69	-	-
Youth Artivists for Change	4,119	15	5,057	66
UNDP Empowering Communities	3,078	7,160	4,617	771
Australian Embassy	2,460	2,460.00	-	-
UNDP Partneriteti zviceran	1,850	-	16,650	-
Helsinki Committee	1,266	246.81	-	-
Kosova 2.0	-	-	8,120	7,530
<b>Total të hyrat</b>	<b>431,557</b>	<b>420,917</b>	<b>401,432</b>	<b>274,482</b>

**Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë**  
**Shënimet e Pasqyrave Financiare**  
**Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2021**

---

**8. SHPENZIMET E PAGAVE**

	Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)
Pagat bruto	144,057	93,184
Kontributet pensionale	7,203	4,659
<b>Total pagat dhe kontributet pensionale</b>	<b>151,260</b>	<b>97,843</b>

**9. SHPENZIMET OPERATIVE**

	Më 31 dhjetor 2021 (në EUR)	Më 31 dhjetor 2020 (në EUR)
Aktivitetet e projektit	195,912	127,645
Shpenzimet e zyres dhe shpenzimet e tjera operative	37,558	30,756
Konsulentët	36,187	18,238
<b>Total shpenzimet tjera operative</b>	<b>269,657</b>	<b>176,638</b>

**10. NGJARJET E MËPASME**

Nuk ka ngjarje pas datës së raportimit që kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese në pasqyrat financiare të organizatës.